REPUBLIKA E ...
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 12/07/2024
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Viera
01- | 052/01 | 33355

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**Komuna e Drenasit**
**Opština Drenas –Municipality of Drenas**

**Drenas, 12 korrik 2024**

Për: **Ramiz Lladrovci,** Kryetar i Komunës së Drenasit

Nga: **Fatlinda Zymberi,** Zyrtare Administrative në DKRS

Lënda: **Raporti (me komente) mbi ecurinë e hartimit të Draft Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029**

---

Ky dokument është një raport përmbledhës mbi ecurinë e hartimit të Draft Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029, komentet dhe trajtimi i tyre nga grupi punues.

## NARRATIVI

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5-*Zbatimi i standardeve të konsultimit publik* dhe neni 19- *Konsultimet Publike*.

Me datë 28.03.2024, Kryetari i Komunës së Drenasit ka nënshkruar vendimin për formimin e Komisionit Komunal për hartimin e Strategjisë për Zhvillim dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029.

Komisioni ka për detyrë hartimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029, dërgimin e draft-Strategjisë për konsultim publik, si dhe të gjitha procedurat tjera ligjore deri në miratimin e kësaj Strategjie.

Komisioni Komunal për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029, përbëhet nga:

1. **Laureta Thaqi**-Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme (Alumni);
2. **Enkela Dema**-Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport;
3. **Qëndrim Hoxha**-LDA Ballkan;
4. **Ekrem Franca**-Zyrtarë për Rini në DKRS,

5. **Fatlinda Zymberi**-Zyrtare Administrative në DKRS,
6. **Arben Haziri**-Këshilli i Prindërve,
7. **Learta Mëziu**-Këshilli i nxënësve,
8. **Këshilli i Veprimit Rinor Lokal(KVRL),**
9. **HANDIKOS,**
10. **Shaban Shabani**- AdVOICE (Organizata Qendra për Avokim dhe Angazhim Qytetarë),
11. **Rina Gashi**-Liderët e së Ardhmes,
12. **Krenar Nika**-CEDE,
13. **Doruntina Gashi**-HUMANUS VITA, dhe
14. **Eronita Brahimi**-Shoqëri Civile.

**AKTIVITETET**

Lidhur me Draft- Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029 mbështetur nga Ambasada Amerikane dhe administruar nga KUSA në partneritet me AdVoice (Organizata Qendra për Avokim dhe Angazhim Qytetarë), grupi punues mbajti **takimin e parë** të këtij lloji me datë: **11.04.2024**. Kryetar-ja e komisionit të grupit punues, **Laureta Thaqi**, ka informuar anëtarët tjerë për rëndësinë e Strategjisë duke theksuar se, kjo Strategji është punuar me zyrtarë të projektit LDA Ballkan, e cila ka në fokus zhvillimin e të rinjve si elementet thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel ndërkombëtarë.

Anëtarët tjerë të grupit punues u njoftuan nga kryetar-ja e komisionit me detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë në hartimin e kësaj strategjie, duke dhënë kështu rekomandimet dhe sugjerimet e tyre njëkohësisht.
Anëtarët e komisionit, pranuan koncept-dokumentin ku edhe premtuan se brenda afatit kohor, do ti paraqesin sugjerimet dhe rekomandimet për hartimin final të kësaj Strategjie.

**Takimi i dytë** me komisionin komunal për hartimin e Draft-Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029, u mbajt me datë: **29.04.2024**.

Kryetar-ja e komisionit Laureta Thaqi, tregoi gatishmërinë edhe të kryetarit të komunës, Ramiz Lladrovci, që secilin dokument ta ndaj dhe ta diskutoj me qytetarët dhe të rinjët e Drenasit. Tutje, kryetar-ja e grupit punues shprehu gatishmërinë në pranimin dhe inkorporimin e të gjitha komenteve të qytetarëve, gjithmonë në saje të ligjshmërisë.

| **Komentet nga OJQ Demokracy Plus** | **Përgjigjja nga Grupi Punues** |
|---|---|
| Më poshtë ne kemi ofruar disa komente specifike që i vlerësojmë të domosdoshme të përfshihen në këtë plan veprimi, duke i konsideruar edhe aktivitetet konkrete që i përfshinë strategjia juaj, me qëllim që ky plan i veprimit të jetë i zbatueshëm. | |

| | |
|---|---|
| **Te Aktivitetet;**<br>Për të siguruar një plan veprimi të plotë dhe efektiv, duhet që në këtë tabelë të shtohet një kolonë për **produktin (output)** për secilin aktivitet. Çdo aktivitet duhet të reflektojë qartë rezultatin e pritshëm në kolonën e shtuar, duke përshkruar saktësisht atë që synohet të arrihet. Kjo përfshin përshkrimin e rezultateve specifike që priten si, për shembull, numri i të rinjve të trajnuar ose rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në qeverisjen lokale etj. Kështu, plani do të ofrojë një pamje më të qartë të objektivave dhe të arriturave të mundshme, duke e bërë më të lehtë monitorimin dhe vlerësimin e progresit.<br>Si shembull konkret, do të listojmë treguesit (në këtë fazë si tekst) për secilin aktivitet të **Objektives së parë** që duhet të vendosen në pjesën e produktit/output, e që pastaj mund të vazhdohet me logjiken e njëjtë të plotësohet ajo kolonë (pasi që të krijohet) edhe për aktivitetet tjera. | Në planin e veprimit kemi shtuar kolonën 'Rezultatet e pritshme' për secilën objektiv. |
| **Te Krijimi i Programeve të Trajnimit;**<br>Plani i veprimit duhet të jetë më specifik dhe i detajuar që përshkruan hapat konkret. Në këtë pikë përshkrimi i programeve të trajnimit është i paqartë.<br>Specifikoni në këtë pjesë llojet e trajnimit (p.sh., aftësi teknike, aftësi të buta, trajnim specifik për industri, fushat e teknologjisë së informacionit, menaxhimit të biznesit etj.) | Llojet e trajnimit janë të përfshira te objektiva në strategji, përkatësisht pika 1.1, te objektiva "Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme" |
| **Te Krijimi i Programeve të Trajnimit;**<br>Në kolonën që kemi rekomanduar që të krijohet në tabelë për output/produkti, paraqitja e rezultateve duhet të paraqitet si teksti më poshtë:<br>Numri i programeve të trajnimit dhe numri i të rinjve të trajnuar përmes këtyre programeve. | Numër nuk kemi paraqitur vetëm rritja e mundësve për të rinjtë për trajnime |
| **Te ofrimi i mundësive:**<br>Rekomandojmë që në këtë pikë të shtohet:<br><br>Bashkëpunimi me institucione dhe biznese të ndryshme lokale në fushën e industrisë, teknologjisë dhe kompanive prodhuese për të krijuar vende për punë praktike çdo vit për maturantët/studentët. | Kjo është përfshirë në strategji te pika 1.2, te objektiva "Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme' |
| **Te Punësimi;**<br>Si produkt/output duhet të jetë:<br>Numri i mundësive të ofruara për praktikë dhe punësim dhe numri i të rinjve të angazhuar në këto praktika dhe punësime. | Është përfshire te plani, 'Rezultatet e pritshme' rritja e mundësive të praktikes dhe punësimit për të rinjtë në institucione, kompani e organizata. Numri si shifër nuk përfshihet. |
| **Te Mentorimi;**<br>Rekomandojmë që të shtohet në këtë pjesë:<br>Krijimi i një programi mentorimi ku profesionistë me përvojë nga fusha të ndryshme ofrojnë mbështetje/seanca udhëzuese një për një për të rinjtë - kjo me qëllim që t'i ndihmojë ata në zgjedhjet e duhura akademike dhe profesionale që përputhen me interesat dhe aftësitë e tyre. | Është përfshirë te pika 1.3, objektiva "Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme". |
| **Te Mentorimi;**<br>Për pjesën e Produkti/output shto tekstin: | Nuk është e nevojshme të përfshihet numri. |

| | |
|---|---|
| Numri i seancave të mentorimit dhe këshillimit të realizuara dhe numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në to. | |
| **Organizimi;**<br>Specifikoni llojet e ngjarjeve dhe punëtorive si dhe numrin e tyre, shembull: seminare dhe takime me punëdhënës potencial përmes panaireve të karrierës dhe sesioneve informuese me profesionistë të fushave të ndryshme, punëtori për zhvillimin e aftësive për shkrimin e CV-së dhe teknikat e intervistimit. | Janë te specifikuara në strategji, te pika 1, objektiva "Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme" |
| **Te Punëtorive;**<br>Për kolonën e Produkti/output duhet të vendoset:<br>Numri i ngjarjeve dhe punëtorive të organizuara dhe numri i pjesëmarrësve në këto ngjarje dhe punëtori. | Nuk është e nevojshme të përshihet numri. |
| **Zhvillimi i aftësive të buta;**<br>Plani i veprimit duhet të jetë praktik dhe i detajuar me qëllim zbatimin e suksesshëm të tij.<br>Rekomandojmë që të përmenden në këtë pikë se cilat aftësi të buta do të synohen (p.sh., komunikimi, puna në grup, lidershipi) dhe metodat e mësimit të këtyre aftësive. | Janë të përfshira në strategji, te pika 1.5 'Zhvillimii aftësive të buta', objektiva "Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme. |
| **Zhvillimi i aftësive të buta;**<br>Për t'u përfshi si tekst në kolonën e Produkti/output:<br>Numri i të rinjve që kanë ndjekur kurset për zhvillimin e aftësive të buta dhe përmirësimi i nivelit të këtyre aftësive, i matur përmes vlerësimeve para dhe pas trajnimit. | Nuk është e nevojshme të përfshihet |
| **Përgaditja për kërkim të Punës;**<br>Rekomandojmë që të përmendni në këtë pikë specifikat për metodat e përgatitjes për kërkimin e punës dhe burimet e ofruara:<br>Seminare për strategjitë e kërkimit të punës, qasje në portale online të punës dhe ofrimi i seancave të këshillimit të personalizuara për karrierë. Ofrimi i mbështetjes për të rinjtë në përgatitjen e materialeve të aplikimit për punë, si CV-të dhe letrat motivuese. | Është e përfshirë te pika 1.6 "Përgtitja për kërkimin e punës", objektiva "Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme" |
| **Përgaditja për kërkim të Punës;**<br>Të shtohet teksti më poshtë të kolona që duhet të krijohet e Produktit/output:<br>Numri i të rinjve të trajnuar për teknikat e kërkimit të punës dhe numri i tyre që janë aftësuar në përgatitjen e CV-ve dhe aftësive për intervistë.<br>*Të vazhdohet edhe në aktivitetet tjera më poshtë me qasjen e njëjtë plotësimi i kolonës për rezultatet që priten nga secili aktivitet. Fillimisht të vendoset si tekst siç rekomanduam në aktivitetet më lartë, ndërsa në fazat e më vonshme të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit të veprimit, mund të plotësohet me numrat/rezultatet e arritura.* | Nuk është e nevojshme. Pas fillimit të zbatimit do të bëhet komisioni monitorues për zbatimin e këtyre objektivave dhe do të merrën të dhënat për numrin e të rinjvë të angazhuar në trajnime, seminare, etj. |
| **2.2 Krijimi i platformave dhe forumeve**<br>Janë dy aktivitete me renditje 2.2 - të harmonizohen numrat. | Janë harmonizuar |
| **2.2 Krijimi i platformave dhe forumeve** | Janë përmendur te pika 2.1 lloji i platformave dhe formumeve, objektiva e dytë "Përforcimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale" në mënyrë të përgjithësuar. |

| | |
|---|---|
| Përshkruani në këtë pikë natyrën e këtyre platformave dhe forumeve, shtrirjen e tyre dhe rezultatet e pritura.<br>Shembull: Zhvillimi i platformave online për angazhimin e të rinjve në diskutimet e politikave dhe organizimi i forumeve vjetore për të rinjtë. | |
| **2.1 Inkurajimi i përfaqësimit të të rinjve në institucionet lokale**<br>Ka mospërputhje me pikën 2.1 të Strategjisë – të përmirësohet/harmonizohet. | Lëshim teknik, është korrigjuar. |
| **Inkurajimi i përfaqësimit të të rinjve në institucionet lokale**<br>Si do të bëhet kjo? Përfshini shembuj të iniciativave ose strukturave ku të rinjtë mund të përfaqësohen. Inicioni programe (p.sh., trajnime për lidershipin, ëorkshope mbi strategjitë e fushatës etj). | Është përfshirë te strategjia, përkatësisht objektiva e 2 "Përforcimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale" si ndërtimi i kapaciteteve, hapësirave inkurjauese etj. |
| **Ofrimi i trajnimeve dhe aftësive për angazhimin civil?**<br>Të shtohet këtu: organizimi i punëtorive rreth edukimit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë qytetare dhe teknikat efektive të avokimit.<br>Specifiko numrin e trajnimeve/punëtorive që pritet të organizohen për vit. | Janë të përfshira në strategji, pika 2.3 "Ofrimi i trajnimeve dhe aftësive për angazhim civil" i objektivës "Përforcimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale". |
| **2.4 Përdorimi i teknologjisë dhe mediave socialeTë shtohet pjesa nga pika e strategjisë:**<br>Kjo përfshin zhvillimin dhe përdorimin e platformave të mediave sociale dhe aplikacioneve të dedikuara për të lehtësuar komunikimin dhe pjesëmarrjen aktive. | Është e përfshirë në strategji te pika 2.5 "Përdorimi i teknologjisë dhe mediave sociale". Nuk është e nevojshme të ripërseritet. |
| **3.1 Ofrimi i këshillimit individual dhe ndihmës së personave në nevojë?**<br>Përshkruani llojet e shërbimeve të këshillimit të ofruara dhe mbështetjen e ofruar për personat në nevojë.<br>Rekomandojmë të shtohet këtu: këshillime për shëndetin mendor, ndihma psikologjike dhe emocionale, empatia dhe mbështetja emocionale etj. | Këto do të përfshihen përmes projekteve që aplikojnë OJQ-të që merren dhe ofrojnë mbështetje per personat në nevojë. |
| **3.Promovimi i një stili jetese të shëndetshëm dhe ofrimi i shërbimeve për mirëqenie të të rinjve?**<br>**Në objektivin e tretë**, aktiviteti i parë numërohet si "2.6" në vend të "3.1". Kjo mund të çojë në konfuzion kur referohen këto aktivitete. Është e rëndësishme të siguroheni që detaje të tilla të jenë të sakta. | Lëshim teknik, është korrigjuar. |
| **3.2 Organizimi i aktiviteteve fizike dhe rekreativo-sportive:**<br>Ofroni detaje për llojet e aktiviteteve dhe frekuencën e tyre, shembull: organizimi i aktiviteteve fizike dhe rekreative-sportive si vrapimet e organizuara javore/mujore, turne sportive mujore/vjetore etj.<br>Gjithashtu, të harmonizohen numrat: pika 3.3 e strategjisë me pikën 3.2 të planit të veprimit, nuk korrespondojnë. | Nuk është e nevojshme të përmenden të gjitha llojet e aktiviteteve fizike sportive e rekreative. Termi aktivitete fizike iu referohet të gjitha aktiviteteve që kanë të bëje me këtë natyre. Janë harmonizuar pikat. |
| **3.3 Përdorimi i teknologjisë për promovimin e shëndetit:**<br>Shpjegoni se si do të përdoret teknologjia për të promovuar shëndetin, duke përfshirë aplikacionet ose platformat në internet.<br>**Harmonizo këtë pikë me pikën 3.4 të strategjisë!** | Është përmendur tek strategjia, pika 2.5 "Përdorimi i teknokogjisë dhe mediave sociale' objektiva e dytë. Është harmonizuar. |

| | |
|---|---|
| **4.1Promovimi i ndërgjegjësimit dhe motivimit**<br>Specifikoni metodat për rritjen e ndërgjegjësimit dhe motivimit të të rinjve.<br>Rekomandojmë që të shtohet këtu:<br>Fushata në rrjetet sociale dhe programe sensibilizimi në shkolla për të motivuar të rinjtë që të angazhohen në punë vullnetare dhe për të theksuar përfitimet e angazhimit vullnetar. | Metodat janë përfshire te objektiva specifike 5, pika 5.1. Pra janë të përfshira të Strategjia. |
| **4.2Identifikimi i nevojave të komunitetit dhe të projekteve vullnetare:**<br>Si do ta bëni këtë? Përshkruani procesin e identifikimit të nevojave dhe organizimin e projekteve.<br>Rekomandojmë që të shtohet këtu:<br>Do të bëhen anketa në komunitet dhe fokus grupe për të identifikuar zonat që kërkojnë mbështetje vullnetare. | Përmes organizimit të aktiviteteve dhe ngjarjeve në komunitet, takimeve të grupeve rinore etj. Janë përmendur te strategjia, përkatësisht objektiva 5. |
| **4.3 Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve vullnetare**<br>Përmendni në këtë pjesë shembuj të ngjarjeve dhe aktiviteteve vullnetare që pritet të organizohen. | Janë përmendur te pika 5.3 llojet e organizimit të ngjarjeve dhe aktiviteteve vullnetare, objektiva 5. |
| **4.5Ofrimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme:**<br>Specifikoni aftësitë dhe njohuritë që do t'u jepen vullnetarëve.<br>Shembull: mbledhja e fondeve, menaxhimi i projekteve, marketingu, menaxhimi i mediave sociale etj. | Janë specifikuar tek strategjia, objektii 5, pika 5.5 llojet e aftësive që synohen të arrihen. |
| **4.6 Inkurajimi dhe vlerësimi i kontributit vullnetar:**<br>Përfshini më shumë detaje mbi mënyrat se si do të vlerësohen kontributet vullnetare. | Është përfshirë më objektivin 5, pika 5.6 "**Inkurajimi dhe vlerësimi i kontributit vullnetar**", si shpallja e vullnetarit të vitit. |
| **5.1Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve rekreativo-sportive**<br>Ofroni detaje për llojet e aktiviteteve dhe audiencën e synuar.<br>Shembull: liga sportive vjetore, turnet e futbollit, ekspozita arti dhe festivale kulturore që synojnë të rinjtë e moshës 12-25 vjeç. | Grupi punues nuk e sheh të arsyeshme detajet e llojet e aktiviteteve pasi të njëjta janë përfshirë në strategji, objektiva 6, pika 6.1. |
| **5.2 Ofrimi i programeve dhe kurseve artistike dhe kulturore**<br>Përshkruani llojet e programeve dhe kurseve të ofruara. | Janë përshkuar te objektiva 6, pika 6.2. |
| **5.3 Krijimi i ambienteve të mbështetëse për aktivitetet alternative**<br>Jepni shembuj të këtyre mjediseve mbështetëse (p.sh. qendra të artit në komunitet, shkolla muzikore, hapë sira krijuese etj). | Nuk është cështje e grupit punuës ku caktohen këto hapësira. Te objektiva 6, pika 6.3 është cekur sigurimi i hapësirave për të rinjtë të cilat janë përgjegjësi e DKRS-së, DKA-së. |
| **5.4 Organizimi i eventeve kulturore dhe festivaleve rinore**<br>Përfshini më shumë detaje mbi llojin e eventeve dhe festivaleve që do të organizohen. | Janë përmendur te objektiva 6, pika 6.4 |
| **5.5 Përdorimi i teknologjisë për të inkurajuar pjesëmarrjen**<br>Të përmenden detaje mbi mënyrat se si teknologjia do të përdoret për të inkurajuar pjesëmarrjen. | Është përmendur tek objektivi 6, pika 6.5 |

| | |
|---|---|
| **i.Mbështetje e nismave që promovojnë ekonominë e gjelbërt dhe mjediset të pastërta dhe të gjelbra**<br>Kjo objektivë e planit të veprimit këtu nuk lidhet me objektiven specifike 6 të strategjisë, në të cilën thuhet: Inkurajimi i të rinjve për të angazhuar në aktivitete fizike dhe sportive, por edhe nga arti, kultura dhe trashëgimia kulturore.<br>Shih Objektiven specifike 6 të Strategjisë dhe harmonizo numrat me planin e veprimit. | Lëshim teknik, është harmonizuar. |
| **i.1 Inkurajimi i nismave për energjinë e ripërtrishme**<br>Konsideroni përfshirjen e disa shembujve konkret të nismave për energjinë e ripërtëritshme.<br>Promovoni instalimet e paneleve diellore dhe projektet e energjisë së erës në komunitetet lokale. | Është përfshirë të objektivi 7, pikat 7.1, 7.2. |
| **i.2 Promovimi i transportit ekologjik**<br>Ofroni detaje mbi metodat e promovimit transportit ekologjik. | Është përfshirë te objektivi 7, pika 7.2 |
| **i.3 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit**<br>Përfshini më shumë detaje mbi llojin e fushatave që do të organizohen. Sa fushata parashihen për vit? | Është përfshirë te objektivi 7, pika 7.3 |
| **i.4 Inkurajimi i investimeve të qeverisjes lokale në projekte mjedisore**<br>Përshkruani llojet e investimeve që do të inkurajohen. | Investime që kanë të bëjë me projekte mjedisore. Është përshkruar te objektivi 7, pika 7.4 |
| **i.5 Përdorimi i teknologjisë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit**<br>Përmendni disa shembuj konkret të teknologjive që do të përdoren. | Është përmendur te objektivivi 7, pika 7.6 |
| **7.1Krijimi i ambienteve gjithpërfshirëse**<br>Përshkruani në këtë pjesë masat specifike për të siguruar përfshirjen. | Është përshkruar te objektivi 4, pika 4.1 |
| **7.Sigurimi i barazisë dhe pjesëmarrjes së të gjithë të rinjve në jetën sociale dhe publike të komunitetit**<br>Nuk përputhet me objektiven specifike 7 të Strategjisë! Të harmonizohen. | Lëshim teknik, janë harmonizuar. |

Për fund, kryetarja e komisionit për hartimin e Strategjisë, falënderoi anëtarët e komisionit për sugjerimet e dhëna, njëherësh pohoj se draft- Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029 së bashku me inputet do të publikohet në ueb-faqen e komunës në mënyrë që edhe qytetarët të japin kontributin e tyre.

**Publikimet:**

Publikimi i këtij dokumenti për konsultim publik u bë me datë 02.02.2023 i cili ishte i hapur për sugjerime dhe rekomandime deri më 18.06.2024.

Në ueb-faqe zyrtare të komunës:

https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/konsultimet-publike-al/

Në facebook-un e komunës:

https://www.facebook.com/komunadrenas ,si dhe

Në platformën e konsultimeve publike:

https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php

Konsultimi publik me qytetarët u caktua të mbahet me datë 13.06.2024 në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00.

https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/05/Njoftimi-per-konsultim-publik-per-Draft-Strategjine-per-Rinine-pdf.pdf

**Paraqitja tabelore:**

| Takimi i drejtpërdrejtë me qytetarë: **Draft-Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë 2024-2029** | | | |
|---|---|---|---|
| Data: | **13.06.2024** | Koha: | **10:00-10:30** |
| Vendi: | **Salla e Kuvendit Komunal-Drenas** | | |
| Pjesëmarrësit: | Femra | Meshkuj | Totali |
| | **26** | **8** | **34** |
| Komente dhe sugjerime: | **2** | | |
| Kërkesa të pranuara: | **0** | | |

**Komentet:**

**Lendita Elshani nga Handikos-** Përfaqëuese e OJQ-Handikos Drenas unë si anëtare e grupit punues kam parë planin ku disa shuma të cekuara mendoj që janë shuma të vogla për Organizatat kan mundsi me apliku, edhe pse kjo është shuma që Komuna ka mundësi përkrahje por mendoj që në të ardhmen kur Komuna ka mundësi bashkëpunimi Organizatat e jashtme kur të shohin këto

shuma të vogla nuk është e mirë se ata kanë mundësi më të mëdha të përkrahjes dhe pse mos të kemi mundësi të përfitimit më të mëdha të fondeve nga ana e tyre.

**Doruntina Gashi** nga **HUMANUSVITA**- Jam e lumtur per kete dokument strategji qe eshte shum i rendesishem dhe qe jam pjese e grupit punues te kesaj strategjie dhe qe komuna na ka ftu si ojq qe ka qen shum e rendesishem rrjetizimi dhe bashkepunimi si dhe me kete strategji si baze e forte bashkepunimi, ju faleminderit te gjithve per bashkepunimin.

**Bekim Dobra-Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun në Komunën e Drenasit** Faleminderit për komentet dhe sugjerimet tuaja. Deshta te rikujtoj qe afati ligjor per pranimin e komenteve ne forme elektronike eshte deri me daten 18 Qershor para se i njejti te miratohet ne mbledhjen e kuvendit dhe do te pregaditet dokumenti nga grupi punues dhe te merr formen finale pas shyrtimit te ligjshmerise nga ana e Ministrise se pushtetit Lokal dhe te jete ne ekzekutim. Faleminderit per pjesemarrjen.

**PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Ky raport është rezultat i një procesi vlerësues i cili pasqyron të dhënat dhe aktivitetet e përmbledhura në një format të shkurtër.

Raporti është paraqitur me objektiva, aktivitete, bartës të aktiviteteve si dhe me afate kohore ku edhe ofron një pasqyrë të qartë dhe me informacione më konkrete rreth hartimit të .

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e komisionit komunal për hartimin e planit,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik,
4. Foto nga konsultimi publik me qytetarët,
5. Lajmi për mbajtjen e konsultimit publik.

Përpiluar nga:
**Fatlinda Zymberi**

Zymberi
______________

Zyrtare Administrative në DKRS

Monitoruar nga:
**Bekim Dobra**

Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

Nr 01-030101-15523 dt.28/05/2024

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

# VENDIM

I. Formohet grupi punues për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029.

II. Grupi punues përbëhet nga këta anëtarë:

1. Laureta Thaqi- Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme (Alumni)
2. Enkela Dema- Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Qendrim Hoxha- LDA Ballkan
4. Ekrem Franca- Zyrtar për Rini në DKRS
5. Fatlinda Zymberi- Zyrtare në DKRS
6. Arben Haziri- Këshilli i Prindërve
7. Learta Mëziu - Këshilli i nxënësve
8. Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL)
9. HANDIKOS
10. Shaban Shabani, AdVOICE
11. Rina Gashi – Liderët e së Ardhmes

12. Krenar Nika- CEDE

13. Doruntina Gashi- Humanus Vita

14. Eronita Brahimi, Shoqëri Civile

III. Grupi i emëruar si në pikën II të këtij vendimi ka për obligim të mbaj takime pune dhe konsultative me të gjitha grupet e interesit.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

V. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

*- Zyrës së Kryetarit*

*-Anëtarëve të Grupit Punues*

*- DKRS-së*

*- Arkvit komunal*

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

**LISTA E PJESËMARRËSVE TË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E RINISË- DATA E TAKIMIT 18.06.2024**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita | Nr telefonit, Email-i | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Lumturie Thaqi | Drejtoreshë e DAP-së | lumturie.thaqi@...gov.net | [signature] |
| 2. | Enkela Dema | Drejtoreshë e DKRoS-së | enkela.dema@rks-gov.net | [signature] |
| 3. | FATLINDA ZYMBERI | ZYRTARE PËR ADMINISTRATIVE | fatlinda.zymberi@rks-gov.net | Zymberi |
| 4. | Arben Hazini | Këshilli i prindërve | drenimitadr@gmail.com | AHazini |
| 5. | Donika Zogu | KVRL-Drenas | donika.zogu@outlook.com | [signature] |
| 6. | FATLUM REXHAJ | | fatlum.rexhaj@...com | [signature] |
| 7. | Rina Gashi | OJQ-Liderët e së Ardhmës | rinasgashi@... | [signature] |
| 8. | Krenar Nika | OJQ CEDE | nika.krenar@gmail.com | [signature] |
| 9. | Lendita Elshani | Përfaqësuese Handikos Drenas | handikos.drenas@hotmail.com lenditaelshani@... | [signature] |
| 10. | EKREM FRANCA | Zyrtar i Rinisë | ekrem.franca@rks-gov.net | [signature] |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Komuna e Drenasit**
**Opština Drenas-Municipality of Drenas**
01 Nr. 070/03-26016 datë 31/05/2024

Duke u bazuar ne Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Drenasit/Gllogocit lëshon këtë:

## NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft –Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të rinjve 2024-2029:

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data **31.05.2024** deri me datën **18.06.2024**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me datë **13.06.2024** në Sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora **10:00**.

Komentet dhe sugjerimet tuaja, mund t'i dërgoni deri më datë **18.06.2024** në ora **16:00** në këto adresa; enkela.dema@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje në lidhje me Draft –Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të rinjve 2024-2029 vizitoni vegezat e mëposhtme ku është publikuar ky draft dokument;

Ueb faqja zyrtare e Komunës në rubrikën Konsultimet Publike, në këtë link:

https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/konsultimet-publike-al/

Platforma për Konsultime Publike:

https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php

Rrjetin social të Facebook:

https://www.facebook.com/komunadrenas

**Bekim Dobra**
**Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun**

Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

**Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik për Draft –Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e të rinjve 2024-2029**

| Nr. rendor | Emri | Mbiemri | Nr tel | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Eknem | Franca | | [signature] |
| 2. | Doruntina | Gashi | | [signature] |
| 3. | Imer Bineku | Bineku | | [signature] |
| 4. | Jehona | Elshani | | [signature] |
| 5. | Arblinda | Murtezi | | [signature] |
| 6. | Floriana | Hasi | | [signature] |
| 7. | Learta | Mëziu | | [signature] |
| 8. | Arben | Haziri | | [signature] |
| 9. | Arbenitë | Rama | | [signature] |
| 10 | Afërdita | Qorri | | [signature] |
| 11 | Mimoza | Berisha | | [signature] |
| 12 | Erolla | Ajdarazga | | [signature] |
| 13 | Viktor | Popoviq | | [signature] |
| 14 | FATLINDA | ZYMBERI | | [signature] |
| 15 | Edonë | Tahiraj | | [signature] |
| 16 | Aurela | Sakiti | | [signature] |
| 17 | Qëndrim | Berisha | | [signature] |
| 18 | FATLUM | REXHAJ | | [signature] |
| 19 | Bekim | Dobra | | [signature] |
| 20. | Gentiana | Qela | | [signature] |
| 21 | Gëzim | Hajdini | | [signature] |
| 22 | Luljeta | Nebiu | | [signature] |
| 23 | Majlinde | Haliti | | [signature] |
| 24 | Sherife | Xhemajlaj | | [signature] |
| 25 | Nezona | Hajrizaj | | [signature] |
| 26 | Bislime | Dvorani | | [signature] |
| 27 | Antigona | Bucolli | | [signature] |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 28 | Arlinda | Kukaj | [signature] | |
| 29 | Shkendie | Leku | [signature] | |
| 30 | SHEHRIJE | MUSTAFA | [signature] | |
| 31 | ZYBADETE | NISHORI | [signature] | |
| 32 | QENDRESE | XHEMA | [signature] | |
| 33 | Rahima | Gjoka | [signature] | |
| 34 | Leonora | Shala | [signature] | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

P.s: Ne këtë takim do të ketë edhe fotografi dhe me nënshkrimin e juaj pajtoni që fotografitë e takimit të përdoren për komunikim zyrtar.















